

VENDIM
Nr. 433, datë 22.6.2022

**PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT, PARAUNIVERSITAR,
TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË “ERNEST KOLIQI INTERNATIONAL
SCHOOL”, KU MËSIMI ZHVILLOHET NË GJUHËN ANGLEZE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, të arsimit të mesëm të lartë “Ernest Koliqi *International School*”, me kohë të plotë, i cili ushtron veprimtarinë arsimore, në adresën: autostrada “Tiranë-Durrës”, km 8, Kashar, Tiranë. Në këtë institucion arsimor mësimi zhvillohet në gjuhën angleze, ndërsa lëndët “Gjuhë shqipe”, “Letërsi”, “Histori e kombit shqiptar” dhe “Gjeografia e Shqipërisë” zhvillohen detyrimisht në gjuhën shqipe.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë dhe institucioni arsimor privat, parauniversitar i arsimit të mesëm të lartë “Ernest Koliqi *International School*” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj